



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.4, datë 08.11.2022

PËR
RINOVIMIN E LEJES NR.921/1 PROT., DATË 29.9.2017
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.16, DATË 13.9.2017 “PËR
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË
AMBALAZHUAR” SUBJEKTIT “ALTIN DERVISHI”

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.921/1 prot., datë 29.9.2017 miratuar me vendimin nr.16, datë 13.9.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman për “Përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar” subjektit “Altin Dervishi” me Adresë Njësia Administrative Karbunarë Lushnje Qarku Fier.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë

Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)

- X= 480008.6; Y= 4532386.9; Z= 141 m.m.n.d
- Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=1 l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

